

VENDIM
Nr. 92, datë 27.2.2019

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 378, DATË 12.8.1999, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR KALIMIN E SË DREJTËS SË PËRFAQËSUESIT TË PRONARIT
PËR DISA OBJEKTE, PRONË PUBLIKE, ORGANEVE TË QEVERISJES VENDORE”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr. 7926, datë 20.4.1995, “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të ndryshuar, të neneve 13 e 15, shkronja “c”, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2003, “Për pasuritë e paluajtshme shtetërore”, të ndryshuar, dhe të neneve 3 e 8/“a”, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

1. Në listën e objekteve, që i bashkëlidhet vendimit nr. 378, datë 12.8.1999, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, pasuria “Metalike Tërana, Laprakë Tiranë me sipërfaqe prej 13 000 m²” ndryshohet në “Metalike Tërana, Laprakë Tiranë me sipërfaqe prej 8010.6 m²”.
2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama